



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË  
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË-  
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te neneve 12, paragrafi 2, shkronja (c), 17 paragrafi 1, shkronja (o), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, nenit 7, pika (1) lidhur me nenin 10, të Ligjit Nr-04/L-071, për Sistemin e Adresave “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.29/2011”, neneve 15, paragrafi 1, shkronja (o), 29, paragrafi 2, shkronja (d), te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 23.11.2018, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Me këtë vendim **MIRATOHET** raporti i komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e zonave të qarkullimit publik në territorin e Komunës së Suharekës dhe bëhet ndryshimi i emërtimeve të rrugëve sipas emërtimit të Komisionit të ankesave.

### Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për urbanizëm dhe planifikim në Komunën e Suharekës.

### Neni 3

Pjesë përbërse e këtij vendim është raporti i emërtimit të zonave të qarkullimit publik në territorin e Komunës së Suharekës i hartuar nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave për sistemin e unifikuar të adresave.

### Neni 4

As një ndryshim-plotësim i emetimit të zonave të qarkullimit publik si; bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve, parqeve dhe unazave rrugor nuk do të lejohet brenda periudhës 10 vjeçare.

### Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqytres, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË

01-Nr-016-74585  
Me datë 26.11.18

